



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRI

Nr. 6398 prot.

Tiranë, më 14.08.2019

URDHËR

Nr. 465, datë 14.08.2019

PËR

“DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË
DERRAVE TË SHFAQUR NË ESTONI, LETONI, LITUANI, POLONI DHE
UKRAINË”

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43 i Ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, informacioni i marrë nga faqja zyrtare e Komisionit Evropian dhe njoftimet e menjëhershme të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE).

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga shteti i Estonisë, Lituaniës, Letonisë, Ukrainës, Polonisë (rajoni përkatësisht, Mazowieckie, Lubelskie, dhe Warminsko-Mazuskie), për në territorin e Republikës së Shqipërisë e të gjithë kafshëve të gjalla të llojit derra shtëpiake dhe të egër dhe produkteve të tyre.
2. Ndalimin e importit nga nga shteti i Estonisë, Lituaniës, Letonisë, Ukrainës, Polonisë (rajoni përkatësisht, Podlaskie, Mazowieckie, Lubelskie, dhe Warminsko-Mazuskie), për në territorin e Republikës së Shqipërisë për:
 - a) spermën dhe embrionet e kafshëve të llojit derra;
 - b) mishin e freskët dhe nënproduktet e tij, të kafshëve të llojit derra;
 - c) materialin patolgjik dhe produkteve biologjike të kafshëve të llojit derra.

